



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.1066/23

GJYKATA KOMERCIAALE E KOSOVËS – Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Franciska Zhitija Ymeri kryetare e kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Faton Bajrami, anëtarë të kolegjit, në konfliktin administrativ të paditësit Shtëpia Botuese “N.Sh Luarasi” me numër unik identifikues të biznesit 810495152, me seli në Prishtinë, rr.”Hamdi Hajziri 1, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “Pro Juris”, me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit Qeveria e Republikës së Kosovës (MASHT), duke vendosur lidhur me ankesën e të paditësit, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Administrative K.A.nr.294/23 të datës 24.07.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 05.09.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditësit Shtëpia Botuese “N.Sh Luarasi” me numër unik identifikues të biznesit 810495152, me seli në Prishtinë, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Administrative K.A.nr. 294/23 të datës 24.07.2023, Vërtetohet.

## A r s y e t i m i

Me Aktvendimin e ankimuar të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Administrative, është vendosur si në vijim;

“REFUZOHET si i pabazuar kërkesa e paditësit Shtëpia Botuese “N.Sh Luarasi”, me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit NR.01B/02B të datës 06.06.2023, i nxjerrë nga MASHT, deri në marrjen e vendimit gjyqësor përfundimtar me padi.”

Kundër këtij aktvendimi ka ushtruar ankesë paditësi përmes të autorizuarit të tij, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjës faktike si dhe për shkak të zbatimit të së drejtës materiale, me propozim që të aprovet ankesa e paditësit si e bazuar, dhe të anulohet aktvendimi i ankimuar.

E paditura nuk ka paraqit përgjigje në ankesë edhe pse ankesën e ka pranuar me datën 03.08.2023.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale të Kosovës, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, dhe nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi Shtëpia Botuese “N.Sh Luarasi”, me seli në Prishtinë, pranë kësaj gjykate ka iniciuar konflikt administrativ me kërkesë për anulimin e vendimit nr.01B/02B të datës 06.06.2023 të paditurës MASHT, si dhe ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të tij, deri në vendim përfundimtar të gjykatës përkitazi me padinë e paditësit.

Gjykata e Shkallës së parë ka marrë aktvendimin e ankimuar me arsyetim se bazuar në nenin 22 par. 2 të LKA-së, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit duhet të plotësohen në mënyrë kumulative kushtet e përcaktuara: a) ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej; b) shtyrja të mos jetë në kundërshtim me interesin publik; c) shtyrja nuk do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar, dhe se në këtë rast nuk janë plotësuar

kushtet ligjore për të aprovuar të njëjtën pasi që paditësi nuk ka argumentuar se ekzekutimi i vendimit do t'i sillte dëm paditësit i cili vështirë do të riparohej si dhe nuk është argumentuar se shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare, kushte këto të përcaktuara në nenin 22 par.2 të LKA-së. Ndër të tjera ka theksuar se gjykata vlerësoi pretendimet e paditësit të paraqitura në padi por të njëjta nuk i ka mbështetur në argumente të besushme apo prova me të cilat do ti arsyetonin pretendimet e paditësit, edhe pse pretendimet për dëmin financiar i bazon në kontratën e tenderit për një vit shkollor në total prej 309,003.00euro, në asnjë provë nuk është bërë e besushme se një dëm i tillë është i pariparushëm për paditësin. Po ashtu gjykata e shkallës së parë në aktvendimin e ankimuar ka cek se duke pas parasysh arsyet për të cilat MASHT ka vendosur të largohet nga përdorimi teksti me titull “Matematika 3B” për klasën e tretë, nga Shtëpia Botuese “Luarasi”, me arsyetim se nga Komisioni janë konstatuar lëshime të theksuara përmbajtësore, dëmtimi i interesit publik që do të shkaktohej nga shtyrja e ekzekutimit të vendimit kontestues, e mbi peshon interesin financiar të paditësit. Pa paragjykuar ligjshmërinë e vendimit kontestues që bie në kompetencë të procedurës së rregullt administrative, përdorimi i teksteve shkollore për arsimimin e nxënësve të klasës së tretë në të cilat janë konstatuar lëshime përmbajtësore paraqet dwm të konsiderushëm dhe të pariparushëm të interes publik. Ngase nxënia e mësimave për një vit të shkollës fillore, të cilët janë më së shumti të dëmtuar nga përdorimi i teksteve me lëshimet përmbajtësore në tekstet shkollore, e në rastin konkret librin e Matematikës 3B me lëshime të pakontrolluara nga paditësi dhe deri tash të pakontrolluar edhe nga e pala kundërshtare MASHT. Interesi publik në edukim dhe arsimim cilësor është obligim i institucioneve shtetërore që në vazhdimësi të vlerësojnë parregullsitë që paraqiten gjatë procesit dhe të marrin masa të menjëhershme për evitimin e pasojave me qëllim të ruatjes e standardeve edukative arsimore dhe përmbushjes së detyrimeve ligjore e kushtetuese. Dhe krejt në fund ka cek se aktvendimin e ankimuar e ka mbështetur në nenin 13 par 1 nën par 1.12 lidhur me par 5 të Ligjit nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 22 par 7 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e tillë juridik të gjykatës së shkallës së parë, nga se edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet për shtyrjen

e ekzekutimit të aktit administrativ të paraparë në nenin 22 par.2 të Ligjit 03.L-202 për Konfliktet Administrativ.

Me këtë dispozitë juridike është paraparë që shtyrja mund të bëhet: nëse ekzekutimi i aktit administrativ do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do ti sillte ndonjë dëm palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar. Në rastin konkret paditësi, me propozimin e ushtruar, kërkon që të caktohet shtyrja e ekzekutimit të vendimit nr. 01B/02B të datës 06.06.2023 e lëshuar nga MASHT, deri në vendosjen meritore të padisë lidhur me këtë lëndë.

Duke i marrë parasysh pretendimet ankimore të paditësit, në ankesë ndaj aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, Kolegji vlerëson se të njëjtat janë jo të qëndrueshme, të pamjaftueshme dhe jo bindëse për tu aprovuar ankesa dhe për tu lejuar shtyrja e ekzekutimit të vendimit të ankimuar deri në vendosjen sipas padisë së paditësit. Ngase edhe vlerësimi i Kolegjit është se nuk janë përmbushur kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të ankimuar, siç parashihet në nenin 22 par.2 të LKA-së. Sepse, kërkesa tërësisht është e mbështetur në faktet që kanë të bëjnë me çështjen kryesore, për të cilat gjykata do të vendosë në mënyrë meritore pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të kërkesëpadisë për anulimin e vendimit të kontestuar, por të cilat tani nuk janë me ndikim për vlerësimin e besueshmërisë së kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kontestuar.

Mbi këtë gjendje të fakteve, Kolegji gjen se Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë për Çështje Administrative, në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesës së propozuesit, me të cilën ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të paditurit MASHT, se nuk është cenuar ligji në dëm të ankuesit, me rastin e refuzimit të propozimit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kundërshtuar. Meqë në këtë rast paditësi, nuk ka bërë të besueshme pretendimet se janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ, e me të cilin do të arsyetohej shtyrja e ekzekutimit të vendimit duke ju referuar dispozitave ligjore, të nenit 22 par.2 të LKA-së. Prandaj, pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së aktvendimit nuk i ka vlerësuar drejtë provat e paraqitura, dhe se nuk i ka konstatuar drejt gjendjen

faktike, janë të pabazuara dhe të paqëndrueshme. Sepse, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate aktvendimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Andaj, ankesa si e tillë refuzohet, ndërsa aktvendimi i ankimuar vërtetohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 209 par.1 nën b) të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.1066/23 datë 05.09.2023

Kryetarja e Kolegjit  
Franciska Zhitija Ymeri